

 AGENCIA E LUFTES KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIA RYBY KOPRYBUE AGENCY FOR THE FIGHT AGAINST CORRUPTION		Nr. regj. 03-4603/12
Dep. DPK/DMP	Nr. detyrës 02	Data 24.12.2012

GJL. Nr. 1109/2012

GJYKATA E LARTË PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare, Dalip Bega dhe Ramiz Kuqi anëtarë, me pjesëmarrjen e Sek. juridike Nexhmije Abazxhik, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga Agjencioni Kundër Korrupsionit i Republikës së Kosovës, kundër aktvendimit të Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Dragash, Nr. regj. 641/2012 të dt. 14.08.2012, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 konform neni 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 24.10.2012 merr këtë

A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e BAZUAR.

ABROGOHET aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Dragash, Nr. regj. 641/2012 të dt. 14.08.2012, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale për Kundërvajtje në Dragash, sipas aktvendimit Nr. regj. 641/2012 të dt. 14.08.2012, të pandehurën Zinaida Elmazi nga fsh. Mlikë K. Dragash, e ka shpallë përgjegjës sepse: si zyrtare e lartë publik, në afatin e përcaktuar ligjor gjegjësisht deri më dt. 31. mars 2012, nuk e ka përmbushur obligimin ligjor nuk e ka plotësuar dhe dorëzuar formularin për deklarimin e pasurisë Agjencionit kundër korrupsionit, më çrast e pandehura ka kryer kundërvajtje të sanksionuar sipas nenit 17 pika 1/3 të Ligjit nr. 04/L-050, konform të nenit 10 të LK. bëhet zbutja e dënimit dhe e pandehura dënohet me QORTIM.

Me të njëjtin aktvendim e pandehura është e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro.

Kundër këtij aktvendimi Agjencioni Kundër Korrupsionit i Republikës së Kosovës, ka paraqitur ankesë, për shkak të vendimit mbi dënimin, me arsyetim se Gjykata komunale për kundërvajtje në Dragash, duke e aplikuar nenin 10 të LK. i shqipton masën edukative Qortim, edhe pse të gjitha faktet dhe rrethanat tregojnë se e pandehura e ka kryer veprimin kundërvajtës, për mos deklarimin e pasurisë e cila është një përgjegjësi e lartë publike dhe obligim për të gjithë zyrtarët e lartë publik. Gjykata e Lartë përmendur nuk e ka shqiptuar dënimin meritor ndaj të pandehurës në pajtim me Ligjin nr. 04/L-050, këtë dënim e zbutë në një masë të madhe ku bie në kundërshtim me rregullat mbi zbutjen e dënimit të përcaktuar në nenin 9 të LK-së dhe ligjin e lartë përmendur. Andaj kërkojnë nga Gjykata e Lartë për Kundërvajtje që të prishet aktvendimi mbi dënimin e shqiptuar dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe të njëjtës ti shqiptohet dënimi meritor në pajtim me ligjin nr. 04/L-050.

Kolegji i kësaj duke i shqyrtuar thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se sipas detyrës zyrtare se ankesa e paraqitur është e bazuar kurse aktvendimi i goditur abrogohet dhe lënda kthehet Gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Kolegji pas shqyrtimit të thënieve në ankesë, aktvendimin e goditur dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se Gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar drejtë kur të pandehurën e ka shpallur përgjegjës dhe i ka shqiptuar masën e Qortimit për shkak se nuk është vërtetuar gjendja faktike, gjë që bazohet në faktin se e pandehura fare nuk është marrë në pyetje, por

03-4603/12/02
fuz

2.

gjykatës i ka ofruar një deklaratë me shkrim e cila nuk mund të pranohet si provë valide për shkak se është fotokopje. Megjithatë edhe sikur të supozohej se deklarata është e pranueshme në bazë të përmbajtjes së saj konstatohet se e pandehura nuk e ka pranuar kundërvajtjen me të cilën ngarkohet duke thënë se: “ nuk e kemi pas në dispozicion formularin përkatës për deklarimin e pasurisë”, kurse gjykata nuk ka nxjerrë asnjë provë tjetër për ta vërtetuar gjendjen faktike.

Kolegji konstaton se sipas detyrës zyrtare se aktvendimi i goditur është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave procedurale përkatësisht të nenit 204 al. 5 të LK-së, në pjesën që ka të bëjë me arsyetimin e aktvendimit të goditur i cili është kundërthënë me dispozitivin e tij për shkak se në dispozitiv theksohet se e pandehura e ka kryer kundërvajtjen me të cilën ngarkohet, kurse në arsyetim nuk është cekur asnjë provë me të cilën do të dëshmohej një gjë e tillë përkundrazi bazohet në deklaratën e të pandehurës e cila është mohuese. Gjersa sa i përket masës së shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë Qortim konform të nenit 10 të LK-së, për të cilën parashtruesi i ankesës e godet aktvendimin e atakuar, Kolegji nuk është lëshuar në vlerësimin e asyeshmërisë së saj për shkak se nuk është vërtetuar gjendja faktike si dhe aktvendimi është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave procedurale.

Kolegji konstaton se me që e pandehura nuk është marr në pyetje, se në deklaratën e vet fotokopje (jo valide) të deponuar në gjykatë nuk e pranon kundërvajtjen me të cilën ngarkohet, kurse gjykata e shkallës së parë nuk e ka nxjerrë asnjë provë tjetër për ta vërtetuar gjendjen faktike se aktvendimi i goditur është i bazuar vetëm në një kopje të deklaratës së të pandehurës e cila është mohuese, se gjendja faktike ka mbetur e pa vërtetuar se aktvendimi i goditur është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave procedurale, si i tillë është i paqëndrueshëm dhe abrogohet kurse lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në plotësim procedure dhe rivendosje.

Në plotësim të procedurës Gjykata e shkallës së parë, duhet të kryej këto veprime procedurale: që ta ftoj të pandehurën në mënyrë të rregullt dhe ta merr në pyetje me procesverbal për ta dhënë mbrojtjen e vet dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat për veprën kundërvajtëse me të cilën ngarkohet, të ftoj parashtruesin e kërkesës dhe personin kontaktues që të dëshmojnë se a ishte e njoftuar e pandehura me kohë për obligimin për deklarimin e pasurisë, sipas nevojës të nxjerrë edhe prova tjera dhe pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike duke marr për bazë edhe pretendimet e paraqitura në ankesën e parashtruar të merr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Më sa u tha më lartë në vështrim të nenit 222 të Ligjit mbi kundërvajtjet, u vendos si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk ka vend ankese.

GJYKATA E LARTË E KUNDËRVAJTJES NË PRISHTINË.

GJL. Nr 1109/2012 të dt. 24.10.2012.

SEK. JURIDIKE
Nexhmije Abazxhik

KRYETARJA E KOLEGJIT,
Mejreme Zekaj

